



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR LEZHË
ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR KURBIN

Nr. 452 Prot.

Kurbin, më 20.07.2026

LËNDA: Njoftim për aplikim në listën në pritje.

Në zbatim të Udhëzimit Nr. 4, datë 26.02.2026 për disa ndryshime në udhëzimin nr. 8, datë 3.5.2024 "Për procedurat e pranimit, të pezullimit dhe të largimit të mësuesit nga një vend pune, si dhe administrimit të Portalit "Mësues për Shqipërinë", i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 19, datë 29.08.2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 03.05.2024", pika 1, shkronja "d", në rast se për pozicionet e lira në ZVAP nuk paraqiten kandidatët që plotësojnë kriteret nëpërmjet Portalit "Mësues për Shqipërinë" të ZVAP-it dhe DRAP-it përkatës sipas pikës 11 të këtij kreu, atëher nga ana e ZVAP vijohet me kandidatë të tjerë të interesuar që kanë paraqitur kërkesë dhe janë renditur sipas pikëve në Liste Pritje nga ZVAP. Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Kurbin njofton kandidatët e interesuar që nuk janë pjesë e Portalit "Mësues për Shqipërinë", por plotësojnë kushtet ligjore për ushtrimin e profesionit të mësuesit, të paraqesin dokumentacionin pranë Zyrës Vendore:

Dokumentacioni që duhet të përmbajë dosja:

- Kërkesë me shkrim;
- Curriculum Vitae (CV), me adresë elektronike aktive;
- Kopje të noterizuara të diplomës/diplomave dhe listës së notave;
- Kopje të noterizuar të licencës për ushtrimin e profesionit, (nëse zotëron);
- Dëshmi të noterizuara të njohjes së gjuhëve të huaja, (nëse e zotëron);
- Librezë pune e noterizuar (nëse e zotëron);
- Certifikata trajnimesh me kredite të noterizuar, (nëse e zotëron);
- Fotokopje të kartës së identitetit;
- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- Vërtetim nga prokuroria dhe gjykata se nuk jeni në procedim penal;
- Raport mjeko-ligjor.

Dorëzimi i dosjeve do të bëhet nga **data 21.07.2026 deri më 04.08.2026** me anë të shërbimit postar në adresën e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Kurbin. Pas përfundimit të afatit të aplikimit, dokumentacioni do të shqyrtohet nga komisioni përgjegjës dhe kandidatët do të rënditen në listën në pritje sipas kriterëve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi e cila do të publikohet në faqen zyrtare të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Kurbin dhe do të përditësohet gjatë gjithë vitit shkollor.

DREJTOR

TEUTA MARA



Adresa: Lagjia Nr. 3, Laç, Kurbin

E-mail: zyrakurbin@arsimi.gov.al
Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Kurbin 2026

